

PËRFAQËSIMI POLITIK NË KËSHILLAT BASHKIAKE PAS ZBATIMIT TË KUOTËS GJINORE 50/50:

ÇFARË PO NDODH ME HENDEKUN GJINOR?

Shqipëria renditet ndër vendet europiane me përfaqësimin më të lartë të grave në këshillat bashkiake [1]. Por rritja numerike e grave nuk kufizohet tek këshillat bashkiake—shtrihet edhe në qeveri, Parlament, apo edhe në organizatat bazë të Partisë Socialiste që supozohet të bashkë-drejtohen nga një burrë dhe një grua. Politikanët nuk hezitojnë ta cilësojnë rritjen numerike të grave në politikë si një arritje të rëndësishme. Në takime, tryeza të rrumbullakëta, apo media kombëtare dhe ndërkombëtare, politikanët flasin me krenari për reformat e ndërmarra brenda partive politike dhe përkrahjen e barazisë gjinore në politikë [2]. Në vitin 2016—një vit pas zbatimit të kuotës gjinore 50/50%—ne ndoqëm dhe analizuam mbledhjet e 11 këshillave bashkiake, të realizuara gjatë periudhës gusht – dhjetor 2016. Për të parë ndryshimin në kohë, studiuam të njëjtat këshilla bashkiake në vitin 2018. Përsëri, ndoqëm dhe analizuam mbledhjet e këshillave bashkiake, të realizuara gjatë periudhës gusht – dhjetor 2018 [3]. Për të shqyrtuar si ka ndryshuar përfaqësimi politik në këshillat bashkiake në kohë, në vitin 2023 u rikthyem në të njëjtat këshilla, tanimë për herë të tretë.

[1] Council of European Municipalities and Regions. 2019. "Women in Politics: Local and European Trends." Marrë nga: https://www.iknowpolitics.org/sites/default/files/cemr_study_women_in_politics_en.pdf.

[2] Si gjatë prezantimit të gjetjeve të studimit Matja e Demokracisë së Brendshme të Partive Politike në Shqipëri të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (22 Nëntor, 2022) ku një përfaqësuese e partisë më të madhe në vend tha plot krenari se organizatat politike në bazë kanë arritur barazi të plotë pasi bashkëdrejtohen nga një burrë dhe grua. Ose gjatë vizitës të Kryeministrit në Elbasan, shih <https://ata.gov.al/2023/04/27/rama-grate-dhe-vajzat-socialiste-kane-vendin-dhe-zerin-e-tyre-sot/>

[3] Dauti, Marsela. 2021. "The Newcomer Effect": Gender Quotas, State Reforms and Service Responsiveness in Local Councils." *International Journal of Social Welfare* 30 (3): 330–41; Dauti, Marsela. 2022. "Bystanders or Contesters? Women's Political Representation and Quality of Government in the Local Councils of Albania." *Journal of Women, Politics & Policy* 44 (3): 274–98.

Metodologjia

Grupi i punës ndoqi—dhe më tej transkriptoi—diskutimet e mbledhjeve të këshillave bashkiake, të realizuara gjatë periudhës gusht – dhjetor 2023. Në total, u transkriptuan 49 mbledhje (1,480 faqe). Po ashtu, u realizuan intervista me 20 këshilltarë, gjatë periudhës shkurt – prill 2024, për të kuptuar natyrën dhe arsyet e ndryshimeve në kohë. Shqyrtimi i të dhënave u mbështet në disa metoda: përpunimin e gjuhës natyrore, analizën përshkruese, dhe analizën tematike.

Gjetjet

➤➤➤ PËRFAQËSIMI POLITIK NË KËSHILLAT BASHKIAKE: VËZHGIME NË TERREN

- Llogaridhënia e administratës në nivele të ulta.
- Praktika autokratike gjatë diskutimeve dhe vendimmarrjes.
- Këshilltarët kërkojnë përgjigje, por delegohen tek qeveria qendrore.
- Këshilltarët kërkojnë adresimin e problemeve në qeverinë qendrore, por dekurajohen nga drejtuesit apo administrata e Bashkisë.
- Materialet nuk shpërndahen në kohë dhe në mënyra të ndryshme, në varësi të nevojave të këshilltarëve.
- Këshilltarët janë të pakënaqur me administratën e Bashkisë dhe raportimet gjatë mbledhjeve.
- Probleme të thella me organizimin e dëgjësive publike dhe përdorimin e informacionit të grumbulluar.
- Shumë pak ekspertizë e pavarur gjatë mbledhjeve.
- Shumë pak banorë dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile marrin fjalën.

MARRJA E FJALËS

Gjatë periudhës së marrë në studim, këshilltarët e morën fjalën 8,300 herë. Burrat e morën fjalën 6,169 herë (74.33%) dhe gratë e morën fjalën 2,131 herë (25.67%) (Figura 1).




Figura 1: Frekuenca e marrjes së fjalës sipas gjinisë




Figura 2: Frekuenca e marrjes së fjalës sipas muajit dhe gjinisë

Hendeku gjinor vihet re gjatë të gjithë periudhës. Gjatë të gjithë muajve të marrë në studim, burrat e morën fjalën në më shumë se 70% të rasteve (Figura 2).

Grupi i punës evidentoi 977 raste të ndërprerjes së fjalës (11.77%). Grave ju ndërpritet fjala më shpesh se burrave (Figura 3).




Figura 3: Frekuenca e ndërprerjes së fjalës gjatë diskutimeve

>>> CILËSIA E QEVERISJES

Frekuenca me të cilën gratë e morën fjalën në vitin 2023 (25,67%) ishte më e ulët se në vitin 2018 (34,34%) dhe vetëm pak më e lartë se në vitin 2016 (23,91%) (Figura 4).




Figura 4: Frekuenca (%) e marrjes së fjalës sipas gjinisë dhe vitit




Figura 5: Frekuenca e marrjes së fjalës—cilësia e qeverisjes

Burrat, krahasuar me gratë, kanë më shumë gjasa të marrin fjalën dhe të diskutojnë çështje që lidhen me zbatimin e ligjit. Konkretisht, burrat e morën fjalën 910 herë (14.75%) për të diskutuar rreth kësaj teme, ndërkohë gratë e morën fjalën 272 herë (12.76%). Burrat dhe gratë, statistikisht, kanë të njëjtën gjasë të diskutojnë rreth transparencës dhe paanësisë (Figura 6).




Figura 6: Frekuenca (%) e marrjes së fjalës—cilësia e qeverisjes—sipas gjinisë

Në vitin 2023—krahasuar me vitin 2018—këshilltarët kanë diskutuar rreth zbatimit të ligjit rreth 2 herë më pak. I njëjti konkluzion qëndron edhe në lidhje me transparencën. Ndryshimi më i madh në kohë doli në pah në lidhje me paanësinë, ku këshilltarët, në vitin 2023, e morën fjalën vetëm 174 herë për të adresuar shqetësime që lidhen me mungesën e paanësisë (Figura 7).




Figura 7: Frekuenca (%) e marrjes së fjalës—cilësia e qeverisjes—sipas vitit

SHËRBIMET VENDORE




Figura 8: Frekuenca e marrjes së fjalës sipas shërbimeve

Për të gjitha shërbimet e analizuar—me përjashtim të arsimit—gratë e morën fjalën më pak se burrat. Megjithatë edhe në rastin e arsimit, diferenca me burrat është shumë e vogël (Figura 9).

Këshilltarët e morën fjalën më shpesh për të diskutuar rreth infrastrukturës rrugore dhe transportit si dhe arsimit, ndjekur nga mirëqenia sociale, shërbimet publike, emergjencat/fatkeqësitë, dhe ujësjetllësi (Figura 8).




Figura 9: Frekuenca (%) e marrjes së fjalës sipas shërbimeve dhe gjinisë

SHËRBIMET VENDORE

Arsimi dhe mirëqenia sociale—dy fushat që dominoheshin nga gratë në vitin 2018—në vitin 2023 janë dominuar pothuajse në mënyrë të barabartë nga gratë dhe burrat. Shërbimet publike dhe ujësjellësi—të cilat dominoheshin nga gratë dhe burrat, në mënyrë të barabartë në vitin 2018—u dominuan nga burrat në vitin 2023. Gratë, statistikisht, nuk dominuan në asnjë fushë në vitin 2023 (Figura 10).




Figura 10: Frekuenca (%) e marrjes së fjalës—shërbimet—sipas gjinisë dhe vitit

Shpjegimet e këshilltarëve për ndryshimet e vëzhguara

- Cilësia e qeverisjes në këshillat bashkiake është dobësuar ndjeshëm me ndryshimet e ndodhura në vitin 2019.
- Grave u kërkohet të largohen apo heqin dorë dhe nuk rikandidojnë.
- Burrat shfaqin rezistencë ndaj përfshirjes së grave në diskutime dhe riafirmojnë dominancën përmes taktikave të ndryshme.
- Gratë përfshihen më fort në diskutimet e komisioneve, ndërkohë burrat përfshihen më fort në diskutimet e mbledhjeve.
- Burrat kërkojnë avantazh elektoral duke dominuar edhe në fushat që kanë qenë prioritare për gratë.
- Rritja numerike e grave në këshillat bashkiake përdoret për të penguar avancimin e mëtejshëm të grave në politikë.

»»» KONKLUZIONE DHE SUGJERIME

Statistikisht, nuk u evidentua asnjë fushë ku të kishte patur një lloj progresi për gratë, krahasuar me burrat. Në fakt, e kundërta qëndron. Burrat kanë forcuar pozitat e tyre dominuese karshi grave në Këshill. Në mënyrë ironike, rritja numerike e grave në këshillat bashkiake duket se i ka shërbyer më shumë burrave— duke forcuar pozitat e tyre dominuese gjatë mbledhjeve. Ne evidentuam raste kur gratë vunë në pah hendekun gjinor dhe propozuan ndryshime. Megjithatë, këto ishin raste sporadike, të pamjaftueshme për të nxitur ndryshim brenda këshillave.

Studimi sugjeron se argumenti i rritjes numerike—i prezantuar shpesh dhe me krenari nga partitë politike— duhet të shihet me skepticizëm dhe të kundërshtohen rastet kur ky argument përdoret për të thënë se vendimmarrja po ndikohet fuqishëm nga gratë. Po ashtu, organizatat politike dhe jo-politike (p.sh., forumet politike, aleancat, organizatat e shoqërisë civile) duhet të fokusohen tek pengesat që hasin gratë pasi bëhen pjesë e këshillave bashkiake. Organizatat ndërkombëtare në vend duhet të vendosin në vëmendjen e tyre zhvillimin e programeve që shkojnë përtej rritjes së kapaciteteve të grave dhe progres-raportet nuk duhet të kufizohen tek arritjet numerike. Në fund, sugjerojmë që organizatat e shoqërisë civile t'i konsiderojnë mbledhjet si hapësira ku mund të advokojnë për grupet me të cilat punojnë dhe të zhvillojnë bashkëpunime me këshilltarët.

Autore: Marsela Dauti, PhD & Geldona Metaj, MSW

Kontaktet: marsela.dauti@gmail.com, geldona@gmail.com

Prill 2024, Tiranë, Shqipëri